

## POZICIONIMI INSTITUCIONAL NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Angazhimi i pakushtëzuar për luftë për korrupsionit është diçka e cila vendoset në deklaratat e Qeverisë aktuale, që nga periudha e kohës parazgjedhore. Në seancën e 149-të të Qeverisë u themelua trupi operativ për luftë kundër korrupsionit dhe krimin. Pa marrë parasysh se ky trup u themelua pothuajse dy vjet më vonë se sa koha ideale, gjendja momentale **jep mundësi të tregojë se formimi i të njëjtit nuk është vetëm akt populist dhe reagim mbrojtës por është rezultat i vullnetit politik dhe përkushtimit për luftë serioze dhe sistimore kundër korrupsionit.**

Pikërisht për atë, funksioni i **këtij trupi duhet të jetë koordinues** në vend se të jetë operativ. Qeveria porositi se ky trup do të vehtë në dispozicion të institucioneve të gjyqësorisë. Mirëpo, ai nuk mund të jetë funksioni i trupit të tillë, sepse institucionet individuale tanimë kanë obligim që të bashkëpunojnë në mënyrë të papenguar ma ata. Përkundrazi, ky trup duhet të japë një ide strategjike dhe implementim për reformat dhe në mënyrë të vëmendshme ti vijojë rekomandimet dhe alarmimin e institucioneve të tjera shtetërore, të sektorit joqeveritar dhe të gazetareve.

Krahas demonstrimit të vullnetit politik, ky **trup duhet ta trajtojë edhe përgjegjësinë për mos-veprimin e tërë Qeverisë, e jo vetëm të institucioneve të përfshira në këtë trup.** Anëtarësimi të përfaqësuesve më të lartë nga institucionet trupit i jep një peshë shtesë të investimit i cili bëhet me formimin e këtij trupi.

Duke marrë parasysh se lufta kundër korrupsionit është luftë afatgjate në më tepër fronte, e që ajo të jetë e suksesshme ka nevojë për një qasje gjithëpërfshirëse ndaj të gjitha fushave potencialisht të rrezikshme. Prej aty buron edhe nevoja që në këtë trup të ketë anëtar nga Ministria e financave, me çka do të mundësohej alkimi përkatës i financave të cilat janë tejet të nevojshme për luftë efikase kundër korrupsionit. Në përkrahje të nevojës për përfshirjes së kësaj ministrie shkon edhe lëndueshmëria ndaj korrupsionit në financat publike posaçërisht në pjesën e furnizime publike. Për momentin, në trupin qeveritar anëtarë janë Ministria e drejtësisë, Byroja për siguri publike, Drejtoria e doganave, Drejtoria për zbulim financiar, Drejtoria për zbulim dhe kundër – zbulim dhe Agjencia për siguri kombëtare.

Në procesin e punës së këtij trupi, me rënd[si është të mos rrezikohet pavarësia e institucioneve të tjera . e as të krijohet çfarë do qoftë hapësire për ndikime negative. Prandaj, **nevojitet mekanizëm për bashkëpunim të përhershëm me Komisionin shtetëror për pengimin e korrupsionit (KSHPK).** Duke e marrë parasysh kompetencën e Kuvendit për miratim të Strategjisë Kombëtare për luftë kundër korrupsionit, deputetët kanë rol të rëndësishëm në miratimin e dokumentit në të cilin do të inkorporohen të gjitha faktorët relevant duke mos ekzistuar krijim të kompetencave paralele dhe të ndikimit të ndërsjellë te institucionet.

Projekti “Bisedë për luftë kundër korrupsionit në Kuvendin” (Anti-Corruption Talk in Parliament (ACT in Parliament)) Përfshin aktivitete hulumtuese përfaqësuese me qëllim primar të përkrahjes së procesit reformues në Maqedoninë e Veriut përmes fuqizimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit në raport me luftën kundër korrupsionit.

Projekti i përkrahur nga Fondit kombëtar për demokraci (National Endowment for Democracy – NED) nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për përmbajtjen përgjegjës është IDSCS dhe në asnjë rast nuk i reflekton pozicionet e Fondit kombëtar për demokraci (National Endowment for Democracy - NED).